



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS

Nr. 3234 Prot.

Klos, më 24 . 11 . 2023

PROJEKT VENDIM

Nr. ___ Datë ___ / ___ /2023

PËR DHËNIE MENDIMI PËR FILLIM PROCEDURASH PËR DHËNIE NË PËRDORIM
NGA FONDI PYJOR I SIPËRFAQEVE TË KËRKUARA NGA SUBJEKTE PRIVATE.

Mbështetur ne "Ligjin 139/2015" për vetqeverisjen vendore "Neni 54" shkonja "e" dhe "K", në ligjin nr 48/2016, VKM. 433, datë 08.06.2016, në zbatim të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020, "Për Pyjet" në "VKM. Nr. 888, dt. 27.12.2022, "Për Rastet e Dhënies në Përdorim dhe Nryshimin e Kategorisë së Përdorimit, Procedurat dhe Dokumentacioni Përkatës për Ndryshimet e Sipërfaqeve dhe Pakësimin në Volum nga Fondi PyJOR Kombëtar apo Zgjerimi i tyre", Udhëzimit të Ministrit nr.1, datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullisor publik" dhe V.K.M-së nr. 433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të bashkive të fondit pyjor dhe kullisorë publik", me vendim të Këshillit Bashkiak, brenda territorit Administrativ të të cilit është sipërfaqja pyjore e cila do ti nënshtrohet procedurave të dhënies, i kërkojmë këshillit të Bashkisë të,

V E N D O S Ë:

Miratimin për fillimin e procedurave, për dhënie në përdorim të sipërfaqes nga fondi pyjor i kërkuar nga subjekti privat.

SHOQËRIA "SPV SITROF ENERGY AND CONSTRUCTION" Shpk.

NIUS. M31925015J. Sipërfaqja e kërkuar është 47.5 ha, në Nënngastrat nr.1a, 2a.

Ekonomia Pyjore Balgjaj 2,

Zona Kadastrale: 2337, 3460.

Kodi Kadastral: DI 1302 1a, DI 1302 2a.

Përdorimi i sipërfaqes: Ndërtim të Parkut Fotovoltaik për prodhimin e energjisë elektrike.

KRYETARI I BASHKISË

Valbona **KOLA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KLOS
DREJTORIA E ZHVILLIMIT TE BUJQËSISË DHE PYJEVE
SEKTORI I ADMINISTRIMIT TË PYJEVE DHE KULLOTAVE.

Klos, më ____ . ____ .2023

RELACION SHPJEGUES

PËR DHËNIEN E MENDIMIT PARAPRAK PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE, PËR DHËNIE NË PËRDORIM, TË SIPËRFAQES SË KËRKUAR, NGA SHOQËRIA “SPV SITROF ENERGY AND CONSTRUCTION ” shpk. PËR NDËRTIMIN E PARQEVE FOTOVOLTAIKE TË GJENERIMIT TË ENERGJISË DIELLORE NË FONDIN PYJOR/KULLOSOR.

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Klos

Ky relacion është hartuar duke u bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 57/2020 datë 20.04.2020 "Për Pyjet" , V.K.M-në nr. 434, datë 08.06.2016 ‘Për disa ndryshime dhe shtesa” në vendimin nr. 1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe kriterëve e procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor”.

Nisur edhe nga iniciativa e Qeverisë për nxitjen e prodhimit të energjisë së rinovueshme, shoqëria shoqëria "spv sitrof energy and constrction" shpk., synon zhvillimin e projekteve për ndërtimin e parqeve fotovoltaike për prodhim të energjisë elektrike në, në Ekonominë Pyjore "Balgjaj2", ngastrat nr. 1a dhe 2a, pjesë e teritorit të Bashkisë Klos.

Procedurat që ndiqen për dhënien me qera në fondin pyjor /kullor publik janë mbështetur në VKM. Nr. 888, datë 27.12.2022, "Për Rastet e Dhënies në Përdorim dhe për Ndryshimin e Kategorisë së Përdorimit, Procedurat dhe Dokumentacioni Përkatës për Ndryshimet e Sipërfaqeve dhe Pakësimin në Volum Nga Fondi Pyjor Kombëtar apo zgjerimin e tyre", në pikën 22 dhe 28, të Udhëzimit të Ministrit të Mjedisit nr.1, datë 09.06 2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik", dhe bazuar në kërkesën e subjektit " shoqëria "spv sitrof energy and constrction" shpk., për marrje me qera të një sipërfaqeje pyjore, pronë e Bashkisë Klos për "Ndërtim të parkut fotovoltaik për prodhimin e energjisë diellore", në VKM nr. 559, datë 29.07.2022,"Për caktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore".

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër subjekti kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur vetëm pas lidhjes së kontratës me Bashkinë Klos.

Pagesa fillon pas marrjes së lejes së ndërtimit.

- Ndërtim të parkut fotovoltaik të energjisë diellore:

1.Tarifë në Inproduktive $47.5 \text{ ha} \times 176000 = 8360000$ (tetë milion e treëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. (Shtojca nr. 1, pika 8) për 'Ndërtim Teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj.) '.

Duke ju falenderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

P/Sektorit të Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave

Ing. Kapllan Allamani

